

Përmbledhje Buletini nr.1 për periudhën (Janar – Prill 2018)

Buletini i parë statistikor i vitit 2018, përmbledh rezultatet e të gjitha auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën Janar - Prill 2018. Në këtë buletin përfshihen, dëmi ekonomik i konstatuar, të ardhurat e munguara dhe shpenzimet e kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E), masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, rekomandime për ndryshime apo përmirësim të legjislacionit si edhe kallëzimet penale të përcjella në Prokurori.


1. Raportimi i rezultateve të auditimit Janar – Prill 2018

Raportimi i Rezultateve të Auditimit, është indikator i që reflekton aktivitetin auditues, lidhet ngushtësisht me raportimin e auditimeve sipas llojit të tyre. Përgjithësisht indikator lidhet me numrin e auditimeve, pra veprimtarinë audituese dhe me reflektimin/reagimin e subjekteve ndaj rekomandimeve të KLSH.

Për periudhën janar – prill 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit, *nga 74 auditime të planifikuara për auditim ka përfunduar dhe evaduar në subjekte 20 auditime*, nga të cilat:

- 4 janë auditime përputhshmërie;
- 16 janë auditime rregullshmërie dhe përputhshmërie;
- ☞ 39 janë në proces auditimi në subjekt;
- ☞ Janë në proces evadimi 15 auditime (brenda muajit maj)¹.

Grafik 1: Subjektet e audituara në periudhën janar - prill 2018



¹ Në formularin nr.1 paraqitet dhe statusi i auditimeve që do të evadohen brenda muajit Maj.

2. Rezultatet e auditimeve

Nga auditimet e realizuara gjatë periudhës Janar – Prill 2018 janë konstatuar parregullsi dhe shkelje financiare.


A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 2,581,106 mijë lekë ose 20.2 milionë euro.

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën totale prej 1,942,534 mijë lekë, afërsisht 15.2 milionë euro nga e cila: 959,832 mijë lekë në fushën e të ardhurave, afërsisht 7.5 milionë euro dhe 985,241 mijë lekë afërsisht 7.7 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve.

Në total janë konstatuar shkelje në shumën 4,523, 640 mijë lekë ose afërsisht 35.4 milionë euro.

*Kursi i këmbimit të lekut/euro është kursi i Bankës së Shqipërisë i datës 30.04.2018 në vlerën 127.8.

Burimi KLSH




Burimi KLSH

☞ **Indikatori i dobisë së auditimit** (raporti i fondeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së) si një nga treguesit më domethënës

të performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, për periudhën Janar - Prill 2018 rezulton 21,5 lekë.

3. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara

Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 1,942,534 mijë lekë nga e cila: 959,832 mijë lekë në fushën e të ardhurave dhe 983,220 mijë lekë në fushën e shpenzimeve konstatuar në institucionet:



4. Rekomandimet për masat administrative dhe disiplinore

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara ka adresuar rekomandimet për masat disiplinore dhe administrative, subjekteve të audituara dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në media-n e shkruar dhe atë elektronike.


Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58 dhe Kodin e Punës, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 164 masave disiplinore dhe administrative.

Rekomandime për ndryshime apo përmirësim të legjislacionit

Gjatë periudhës janar – prill 2018 janë rekomanduar gjithsej 14 propozime për ndryshime ligjore, ndryshime që prekin rekomandime për përmirësime në korniza ligjore, në kuadrin të brendshëm rregullativ të institucioneve me synim forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Gjatë periudhës janar – prill 2018 janë rekomanduar nga KLSH 374 masa organizative.

Grafik 3: Masat e rekomanduara nga KLSH për periudhën janar - prill 2018



5. Kallëzimet për ndjekje penale

Gjatë kësaj periudhe, nga ana e KLSH-së janë bërë *11 kallëzime penale*, për drejtues kryesisht të rangut të mesëm dhe të lartë, konkretisht në këto institucione:

- 1) Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (*Titullari i Institucionit*); {indicie}
- 2) Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Kamëz - Vorë (*Ish-përgjegjës i sektorit të legalizimit, Përgjegjës i sektorit të legalizimit, Specialist i sektorit të hartografisë, Ish-përgjegjës i sektorit të hartografisë, Ish-përgjegjës i sektorit të hartografisë, Specialiste në zyrën e legalizimit*);
- 3) ZVRPP Malësi e Madhe (*Ish regjistrues, Ish regjistrues, Ish specialist*); {indicie}
- 4) ZVRPP Elbasan (*Specialiste, Specialist, Ish-regjistrues, Ish-regjistrues, Ish-regjistrues, Ish-regjistrues, Ish-regjistrues, Ish-regjistrues, Ish-regjistrues, Ish-regjistrues, Specialist, Specialist, Ish-specialist*); {indicie}
- 5) Enti Rregullator i Energjisë (ERE) (*Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë*);
- 6) Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (*Ish zv.Drejtor i AAC*);
- 7) Bashkia Belsh (*Kryetar i Bashkisë, Drejtor i Bujqësisë, Ish – përgjegjës i Urbanistikës, Ish-juriste*) {Në cilësinë e anëtarëve të KVO-së};

- 8) Bashkia Belsh (*Kryetar i Bashkisë, Mbikëqyrës i Kontratës, Kolaudatore, Kolaudator*);
- 9) Bashkia Rrogozhinë {indicie};
- 10) Bashkia Rrogozhinë (*Mbikëqyrës i punimeve në shoqërinë "C.G." sh.p.k*);
- 11) Bashkia Rrogozhinë (*Ish-Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë*).


Numri i personave të kallëzuar arrin në 36 persona.

6. Komunikimi me publikun

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar - prill 2018 ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit. Megjithatë, edhe në këto raste KLSH i ka orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cilit institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2018, KLSH ka trajtuar 151 letra dhe ankesa, nga të cilat 15 jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Nga 136 ankesa në kompetencë të KLSH, 101 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 35 janë në proces verifikimi.

☞ Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen fushat kryesore të shqetësimit publik për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 10% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; 67% privatizimit dhe kthimit të pronës; 20% fushave të tjera dhe 3% trajtojnë çështje të ndryshme.

Grafik 4: Fushat kryesore të shqetësimit publik



Burimi KLSH
